

## LETËR PËR PROCEDURAT E MASAVE TË SIGURISË

---

Data e dërgimit (m/d/viti): \_\_\_\_\_

Emri i nxënësit: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

I/e dashur \_\_\_\_\_ :

Njoftimi i Procedurave për Masat e Sigurisë, që kemi bashkangjitur përshkruan të drejtat tuaja dhe procedurat që i ruajnë ato nën ligjet shtetërore dhe federale për arsimin e posaçëm, përfshirë këtu Ligjin për Shkollimin e Individëve me Paaftësi, shkurt 'LSIP 2004'. Këto ligje dhe rregulla përcaktojnë që qendrat lokale të edukimit duhet t'u ofrojnë arsim publik të përshtatshëm falas (APPF), të gjithën nxënësve me paaftësi që kanë nevojë për shkollim të posaçëm. Arsimi publik i përshtatshëm falas (APPF), është termi përmbledhës për shkollimin e posaçëm dhe shërbimet përkatëse, që i ofrohen fëmijës suaj falas, në përputhje me Programin Individual Arsimit (PIA)

Informacioni i mbledhur në këtë Njoftim për Procedurat e Masave të Sigurisë është i rëndësishëm për ju dhe fëmijën tuaj. Ju lutemi kushtojini pak kohë leximit të tij. Megjithëse jemi përpjekur të radhitim shumë informacion në formë të lexueshme, e dimë që ky informacion mund të bëhet i vështirë për t'u kuptuar. Nëse keni nevojë për sqarim, mund t'i kërkonit ndihmë personelit të qendrës lokale e cila i jep fëmijës suaj shkollim gjithashtu, keni të drejtë të informoheni për listën e organizatave që ndihmojnë prindërit për të kuptuar të drejtat e siguruara nga ligjet e mësipërme. disa nga këto organizata janë renditur më poshtë dhe në Njoftimin për Procedurat e Masave të Sigurisë.

Nëse keni shqetësime për programin shkollor të fëmijës suaj, mirë është të kontaktoni mësuesit e fëmijës suaj, drejtorin ose titullarët e shkollës. Ky lloj komunikim shpesh ndihmon në zgjidhjen e problemeve.

Gjithashtu, sipas ligjit federal ju keni të drejtë të bëni ankesë tek departamenti i arsimit të Pensilvanisë dhe/ose të nisni procedura gjyqësore ashtu si përshkruhen në pjesën VI të këtij Njoftimi për Procedurat e Masave të Sigurisë.

Sinqerisht,

[Emri dhe titulli]

## **BURIMET LOKALE PËR PRINDËRIT\***

---

\*Burime shtesë janë renditur në Njoftimin për Procedurat e Masave të Sigurisë.

Nëse keni fëmijë me zhvillim të vonuar mendor dhe/ose shqetësime psikike, ai/ajo përfiton, sipas ligjit për shëndetin mendor dhe/ose zhvillimin e vonuar mendor të Pensilvanisë të viti 1966, dhe ligjit të procedurave të shëndetit mendor të vitit 1976, shërbimet e qendrës lokale për shëndet mendor/zhvillim të vonuar (SM/ZM) si edhe shqyrtim të pavarur mjekësor, psikologjik dhe shkollor, i cili do të kryhet nga një njeri profesional dhe me licence pa asnjë kosto për ju.

EMRI/ADRESA/NUMRI I TELEFONIT TË QENDRËS BAZË TË SM/YM:

DEGA LOKALE E ARC-UT TË PENSLIVANISË:

### **ASISTENCË LIGJORE**

**DISABILITY RIGHTS NETWORK OF PENNSYLVANIA (RRJETI I TË DREJTAVE TË PAAFTËVE TË PENSILVANISË)**

800-692-7443

717-236-8110

[www.drnpa.org](http://www.drnpa.org)

**PENNSYLVANIA BAR ASSOCIATION (SHOQATA E AVOKATËVE TË PENSILVANISË)**

P. O. Box 186

Harrisburg, PA 17108

800-932-0311 (TELEFONI)